



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr 65 dt.20.07.2001

**PER
CAKTIMIN E STRUKTURES, NUMRIT TE PUNONJESVE DHE PAGES SE
POLICISE BASHKIAKE TE QYTETIT TE TIRANES**

Në mbështetje të neneve 14, 15 dhe 17 të ligjit Nr.8224 dt.15.05.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë së Bashkisë dhe Komunës”, ndryshuar me ligjin nr.8335 dt.23.04.1998, pika 3.III, “a” të nenit 10 të ligjit Nr.8652 dt.31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, V.K.M nr.726 dt.21.12.2000 “Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore”, ndryshuar me V.K.M nr.424 dt.11.06.2001, bazuar në relacionin e paraqitur me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak

V E N D O S I

1. Në strukturën e aparatit të Bashkisë Tiranë të shtohen 31 punonjës sipas kësaj ndarjeje:
 - Inspektor 1
 - Policë 30
 - GJITHSEJ 31
2. Të miratohen për këtë qëllim shpenzimet e mëposhtme:
 - Paga 3.600 mijë lekë
 - Sig. Shoq 1.250 mijë lekë
 - Rikonstruksioni godinës në të cilën do të vendoset Pol. Bashkiake 5.000 mijë lekë

3. Fondi prej 4.850 mijë lekësh të përballohet prej të ardhurave në dispozicion të Bashkisë Tiranë ndërsa fondi prej 5000 mijë lekësh për rikonstruksionin e Godinës në të cilën do të vendoset Policia Bashkiake nga Zëri “Ndërtimi i Urës mbi Lanë që lidh 2 segmentet e rrugës “Dëshmorët e 4 Shkurtit”
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Njerëzore dhe Informacionit dhe Drejtoria e Inspektoriatit të Mjedisit Urban
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETARI

Leonidha TOSKA

